

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8308  
E martë, 26 maj 2026  
Çmimi 0.50 €

Nga AAK në "Aleanca",  
Ardian Gjini zgjedhet  
kryetar i ri | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ZGJEDHJE ME EMRA, JO ME ZGJIDHJE | FAQE 4-5



Pa një konfigurim të ri politik dhe kompromis, vota e 7 qershorit mund të riprodhojë të njëjtin ngërç institucional në Kosovë,

vlërësojnë njohësit e zhvillimeve politike. Përplasjet mes pushtetit dhe opozitës së deritashme, fokusimi tek individët dhe

jo programet, si dhe logjika e dominimit mbi bashkëqeverisjen, e mbajnë sistemin në një cikël krize dhe stagnimi, sipas tyre

### AKTUALE



MARRËVESHJA SHBA-IRAN "95% E PËRFUNDUAR", POR JO GATI PËR NËNSHKRIM | F. 2

SHBA: PRESIM QË PLANI I QEVERISË PËR XHANDARMËRINË TË JETË NË PËRPUHTJE ME ZOTIMET PËR RUAJTJEN E PAQES | F. 6

KURTI PREZANTON PROJEKTET PËR KATËR HEKURUDHA DHE PESË DIGA GJATË TAKIMIT ME ODËN TREGTARE KOSOVARO-TURKE | F. 5

### EKONOMI



AKB-ja: 780 EURO PËR PUNËTORËT E SEKTORIT PUBLIK, 100 EURO PËR SEKTORIN PRIVAT - A ËSHTË KJO DREJTËSI EKONOMIKE? | F. 8

### SPORT



KRESHNIK UKA, "YLLI I JAVËS" NË SUPERLIGËN E KOSOVËS NË FUTBOLL | F. 11



KONGRESISTËT AMERIKANË NË BALLKAN, VIZITË EDHE NË KOSOVË | F. 5

GUVERNATORI ISMAILI PJESË E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE PËR AVANCIMIN E PROFESIONIT TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT | F. 8



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# MARRËVESHJA SHBA-IRAN "95% E PËRFUNDUAR", POR JO GATI PËR NËNSHKRIM

WASHINGTON, 25 MAJ - Administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, tha se ShBA-ja dhe Irani janë më pranë një marrëveshjeje bërthamore se kurrë në vitet e fundit, por theksoi se ajo ende nuk është përfundimtare dhe se disa çështje kryesore mbeten të hapura.

Duke folur në një bisedë informuese me gazetarët, zyrtarë të lartë amerikanë thanë se negociatat me Iranin janë rreth "90-95%" të përfunduara dhe se marrëveshja e re pritet të jetë ndryshe nga ajo e arritur gjatë kohës së presidentit Barack Obama, nga e cila Trump u tërhoq gjatë mandatit të tij të parë. "Ajo nuk është negociuar ende plotësisht. Prandaj, mos i dëgjoni humbësit, që kritikojnë diçka për të cilën nuk dinë asgjë", shkroi Trump në platformën Truth Social. "Ndryshe nga ata para meje, që do të duhej ta kishin zgjidhur këtë problem shumë vite më parë, unë nuk bëj marrëveshje të këqija", shtoi ai.

Zyrtarët e administratës theksuan vazhdimisht se nuk do të ketë një marrëveshje të menjëhershme, pavarësisht përpimit të dukshëm në bisedime gjatë fundjavës. "Nuk kemi arritur ende aty", tha një zyrtar i lartë më 24 maj. "Nuk do të nënshkruajmë marrëveshje sot apo nesër", theksoi ai.

## Irani duket se lëshon pe për rezervat e uraniumit

Përpimi më i madh në negociata duket se lidhet me rezervat e uraniumit të pasuruar të Iranit, të cilat, prej kohësh, janë pengesë kryesore në bisedime.

Sipas një zyrtari të lartë të administratës Trump, Teherani ka rënë dakord "në parim" që të heqë dorë nga rezervat e uraniumit pranë nivelit për

armë bërthamore, megjithëse ende janë duke u negociuar mënyrat e zbatimit dhe verifikimit. "Çështja është se si do të bëhet kjo", tha zyrtari, duke kundërshtuar pretendimet se Irani ka refuzuar ta dorëzojë materialin.

Aktualisht, Irani posedon mbi 440 kilogramë uranium të pasuruar në 60 për qind, sipas Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Bërthamore - një nivel shumë përtej nevojave civile dhe vetëm një hap teknik larg nivelit për armë bërthamore.

Burimet iraniane sugjerojnë se një nga zgjidhjet mund të jetë hollimi i uraniumit nën mbikëqyrjen ndërkombëtare të agjencisë bërthamore të OKB-së. Një tjetër zyrtar i lartë amerikan tha se është duke u diskutuar një kornizë që parashikon një afat 60-ditor për finalizimin e një marrëveshjeje të plotë.

## "Pa pluhur, pa dollarë"

Zyrtarët e administratës Trump argumentojnë se korniza e re e marrëveshjes bazohet në kushte të rrepta dhe mekanizma të fortë zbatimi, për dallim, sipas tyre, nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 (JCPOA).

Ata përdorin vazhdimisht shprehjen "pa pluhur, pa dollarë" për të përshkruar strukturën e marrëveshjes së propozuar.

Sipas kësaj kornize, Irani do të përfitojë lehtësim gradual të sanksioneve vetëm pasi të përbushë disa detyrime konkrete, përfshirë eliminimin e rezervave të uraniumit të pasuruar dhe ndalimin e ndërhyrjeve në trafikun detar përmes Ngushticës së Hormuzit. "Nuk do të ketë lehtësim pa e përbushur Irani fillimisht pjesën e tij të



marrëveshjes", tha një zyrtar. Zyrtarët theksuan, gjithashtu, se ShBA-ja nuk do t'i dërgojë Iranit pagesa direkte në para - një referencë e qartë ndaj kritikave të kahershme të republikanëve ndaj administratës së Obamës. "Nëse ata nuk i përmbushin zotimet e tyre, atëherë nuk përfitojnë asgjë. Ne kemi vendosur mekanizma zbatimi", tha një zyrtar.

Sipas administratës amerikane, Irani ka rënë dakord "në parim" që Ngushtica e Hormuzit të mbetet e hapur, pa pengesa apo tarifa për anijet tregtare, ndërsa, në këmbim, Uashingtoni do t'i lehtësojë masat e tij të bllokadës detare.

Megjithatë, zyrtarët theksuan se opsionet ushtarake mbeten në tryezë, nëse diplomacia dështon. "Kemi alternativa. Mund t'u rikthehemi goditjeve ushtarake nëse nuk arrihet marrëveshja", tha një zyrtar.

## Llogaritjet rajonale dhe politika e brendshme në Iran

Zyrtarët e administratës e paraqesin këtë proces jo vetëm si një marrëveshje për çështjet bërthamore, por edhe si pjesë e një strategjie më të gjerë për të ndikuar në balancat e brendshme të pushtetit në Iran. "Qëllimi kryesor është të fuqizohen elementet më të moderuara në Iran, në mënyrë që të zbehet ndikimi i linjës së ashpër", tha një zyrtar, duke shtuar se, sipas inteligjencës amerikane, të moderuarit janë duke fituar terren, edhe pse konservatorët e fortë vazhdojnë të kenë kontroll të konsiderueshëm.

Zyrtarët nuk pranuan të thonë qartë nëse presioni ushtarak apo sanksionet ekonomike kanë ndikuar më shumë në

ndryshimin e qëndrimit të Teheranit, por pranuan se negociatorët iranianë janë duke bërë lëshime - veçanërisht për pasurimin e uraniumit.

Zyrtarët zbuluan, gjithashtu, se Trump u ka bërë trysni liderëve rajonalë, përfshirë ata nga Arabia Saudite, Katari dhe Pakistani, që të mbështesin një proces më të gjerë normalizimi në rajon, që përfshin edhe Izraelin - një kërkesë që, sipas raportimeve, i ka zënë në befasi disa prej tyre. "Kishte heshtje në linjë dhe Trump bëri shaka, duke pyetur nëse janë ende aty", tregoi një zyrtar amerikan.

Aktualisht, Shtëpia e Bardhë është duke bërë përpjekje të shfaqë optimizëm të kujdesshëm.

Zyrtarët këmbëngulin se ka ende shumë punë, përpara se të arrihet një marrëveshje përfundimtare. "Nuk ka marrëveshje, derisa të ketë marrëveshje", tha një zyrtar.

## Izraeli paralajmëron sulme të reja në Libanin jugor, banorëve u kërkohet evakuim



Jerusalem, 25 maj- Forcat Mbrojtëse të Izraelit kanë paralajmëruar një valë të re sulmesh në disa qytete dhe fshatra të Libanit jugor, duke rritur tensionet në një zonë tashmë të goditur nga konflikti.

Zëdhënësi i ushtrisë izraelite, Avichay Adraee, njoftoi se objektiva në jug të Libanit do të goditen si përgjigje ndaj shkeljeve të armëpushimit të

atribuara Hezbollah. Adraee u bëri thirrje banorëve të disa zonave që të largohen menjëherë nga shtëpitë e tyre dhe të shmangin zonat e rrezikut në një distancë prej të paktën 1000 metrash. Sipas tij, çdo prani pranë objekteve ushtarake të Hezbollahut rrezikon jetën e civilëve. Pavarësisht një armëpushimi të ndërmjetësuar nga ShBA,

përplasjet mes Izraelit dhe Hezbollahut kanë vijuar në mënyrë sporadike, duke e mbajtur situatën të tensionuar në kufirin jugor të Libanit.

Konflikti i vazhdueshëm ka shkaktuar viktima të shumta dhe zhvendosjen e mbi një milion personave, ndërsa Libani po përballet me një krizë të thellë humanitare dhe të sigurisë.

# KONGRESISTËT AMERIKANË NË BALLKAN, VIZITË EDHE NË KOSOVË

PRISHTINË, 25 MAJ - Dy kongresistët amerikanë, republikani Keith Self dhe demokrati Suhas Subramanyam, do të qëndrojnë sot në Serbi, ku do të vizitojnë edhe Luginën e Preshevës, të banuar me shumicë shqiptare.

Ata do të priten nga kryetarja e Kuvendit të Serbisë, Ana Bernabiq, në Beograd, prej ku nesër do të shkojnë edhe në Preshevë.

Kryetarja e kësaj komune në jug të Serbisë, Ardita Sinani, shkroi në profilin e saj në Facebook se "Presheva mirëpret delegacionin e Kongresit amerikan". "Një moment historik për Luginën", sipas saj. Me iniciativën e kongresistit Self, anëtarët e Komitetit për Politikë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit amerikan miratuan në janar të këtij viti një projektligj, që i kërkonte sekretarit amerikan të Shtetit të përgatiste një raport gjithëpërfshirës për pozitën e pakicave në Serbi, me fokus të

veçantë te shqiptarët në Luginën e Preshevës.

Në Serbi jetojnë më shumë se 60.000 shqiptarë, të cilët përbëjnë pakicën e katërt më të madhe atje, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, në vitin 2022.

Në raportet ndërkombëtare, Lugina e Preshevës - që përfshin Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin - konsiderohet tërësisht e izoluar dhe thuhet se merr vëmendje vetëm në kohë zgjedhjesh.

Një ditë më herët, Self dhe Subramanyam qëndruan në Sarajevë, ku takuan përfaqësuesit e Presidencës së Bosnje dhe Hercegovinës.

Atje diskutuan për "mënyrat për të forcuar partneritetin dypalësh dhe për të mbështetur stabilitetin në Ballkanin Perëndimor".

Përmes një postimi në platformën X, Ambasada amerikane në Sarajevë nënvizoi se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara ndaj Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe dhe



integritetit territorial të Bosnje dhe Hercegovinës.

Në mesazhin e publikuar nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë Ndërkombëtar (OHR) në Bosnje dhe Hercegovinë me rastin e vizitës së kongresistëve, u theksua po ashtu rëndësia e

angazhimit amerikan ndaj Marrëveshjes së Dejtonit.

Dy kongresistët u takuan me zëvendëspërfaqësuesin e parë të lartë, Louis Crishock, "për të diskutuar situatën politike në Bosnje dhe Hercegovinë". Delegacioni i kongresistëve

amerikanë pritet të qëndrojnë në Kosovë të martën.

Javën e kaluar, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi se ka zhvilluar një takim virtual me një grup kongresistësh, në mesin e tyre edhe Self. "Bashkëpunimi dypalësh në mbrojtje midis Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara është më i fortë se kurrë. Kjo, kryesisht, për shkak të mbështetjes dërmuese dypartiake që Kosova gëzon në Kongresin e SHBA-së", shkroi Kurti në X, pas asaj bisede.

Në fund të prillit, Self, bashkë me kolegët e tij, Ritchie Torres dhe Mike Lawler, propozuan një rezolutë që synon ta shtyjë përpara rrugën e Kosovës drejt NATO-s.

Rezoluta me mbështetje dypartiake thekson, mes tjerash, se "qeverisja demokratike e Kosovës, mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë dhe bashkëjetesa shumetnike përbëjnë një argument bindës për anëtarësimin në NATO".

## TETË ZYRTARË POLICORË NDEROHEN ME MEDALJE PËR SHPËTIM JETE

PRISHTINË, 25 MAJ - Në shenjë nderimi për guximin, profesionalizmin dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të dëshmuar gjatë ndërhyrjes për shpëtimin e jetës njerëzore, duke reflektuar vlera të larta humane, përgjegjësi institucionale dhe gatishmëri për t'u vënë në shërbim të qytetarëve në çdo rrethanë, pas përfundimit të procedurave të parapara sipas udhëzimit administrativ dhe vlerësimit nga anëtarët e komisionit vlerësues, me rekomandim të drejtorit të përgjithshëm të PK-së, kolonel Gazmend Hoxha, bazuar në Ligjin e Policisë, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka dekoruar tetë zyrtarë policorë me Medalje



për Shpëtim Jete.

Ministri Sveçla, gjatë fjalimit të tij ka theksuar se është tejet i lumtur për të nderuar sot punën e tetë zyrtarëve tanë policorë, të cilët me aktin e tyre human e fisnik, duke rrezikuar vetveten, i dhanë kuptim misionit të Policisë së

Kosovës. "Këto akte dëshmojnë se, përveç profesionalizmit të lartë, pjesëtarët tanë policorë bartin edhe vlera të mëdha humane, të cilat ndërveprojnë me detyrën dhe përgjegjësinë zyrtare", ka thënë ai, duke shtuar se akti heroik i

zyrtarëve tanë policorë është dëshmi e qartë e përkushtimit të palëkundur që Policia e Kosovës ka ndaj qytetarëve të Republikës sonë. "Në momente kritike, kur sekondat bëjnë dallimin mes jetës dhe vdekjes, ju veproni me guxim, profesionalizëm dhe humanizëm të jashtëzakonshëm. Kjo është arsyeja që Policia e Kosovës vazhdon të mbetet ndër institucionet më të besuara në vend".

Ndërsa drejtori Hoxha vlerësoi lart veprimin e zyrtarëve policorë, si një akt i jashtëzakonshëm guximi, një nivel i lartë profesionalizmi dhe mbi të gjitha një humanizëm i pastër i tetë zyrtarëve policorë, duke theksuar që ata në momente


kritike, nuk hezituan në asnjë sekondë, por me veprimet e tyre të matura dhe vetëmohuese arritën të shpëtojnë jetë njerëzish. "Veprimet tuaja të guximshme dhe profesionale janë një shembull i mirë dhe një burim i madh frymëzimi për të gjithë zyrtarët policorë që mbajnë këtë uniformë anembanë vendit. Ju vërtetuat se uniforma e PK-së nuk është thjesht një petk zyrtar, por ajo bart mbi vete një peshë të madhe të përgjegjësisë, një mision human dhe një gatishmëri të palëkundur për të shërbyer në çdo rrethanë ndaj qytetarëve dhe vendit, pavarësisht rreziqeve që mund të kanosen", ka theksoi drejtori Hoxha.

## ATK-ja prezanton reformat tatimore të Kosovës në konferencën ndërkombëtare në Athinë

PRISHTINË, 25 MAJ - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Mentor Hyseni, së bashku me zëvendësdrejtorin Sami Salihu, morën pjesë në konferencën ndërkombëtare "Nga Reforma tek Rezultatet: Dëshmi mbi ndikimin e reformës në administratën tatimore", e organizuar nga Autoriteti i Pavarur për të Ardhurat Publike në Greqi, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Konferenca u mbajt në Athinë

dhe mblodhi drejtues të administratave tatimore, ekspertë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të institucioneve financiare nga vende të ndryshme të Evropës dhe rajonit, me fokus në transformimin institucional, digitalizimin, përdorimin e inteligjencës artificiale dhe ndikimin e reformave në administratat tatimore. Në kuadër të sesionit "Renditja e reformave dhe qëndrueshmëria - Cilat zgjedhje në renditjen e

reformave ishin më të rëndësishmet dhe pse? drejtori Mentor Hyseni prezantoi temën "Renditja e reformave dhe qëndrueshmëria - Ndërtimi i besimit, nxitja e rritjes", ku ndau përvojën e Kosovës në procesin e reformimit të administratës tatimore, duke theksuar rëndësinë e ndërtimit të besimit me tatimpaguesit, avancimin e shërbimeve digjitale dhe krijimin e një administrate moderne, transparente dhe efikase.





# ZGJEDHJE ME EMRA, JO ME ZGJIDHJE

Pa një konfigurim të ri politik dhe kompromis, vota e 7 qershorit mund të riprodhojë të njëjtin ngërc institucional në Kosovë, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike. Përplasjet mes pushtetit dhe opozitës së deritashme, fokusimi tek individët dhe jo programet, si dhe logjika e dominimit mbi bashkëqeverisjen, e mbajnë sistemin në një cikël krize dhe stagnimi, sipas tyre

Prishtinë, 25 maj- Një rol i konceptuar si kryesisht ceremonial ka marrë një peshë që i tejkalon vetë kompetencat e tij. Presidenti është kthyer në një krizë politike në Kosovë, duke e çuar vendin drejt zgjedhjeve të reja, por pa garanci se ato do të prodhojnë zgjidhje. Sipas vëzhguesve, vota mund të sjellë rezultat vetëm në një konfigurim të caktuar - përndryshe, rrezikon ta riprodhojë të njëjtin bllokadë që zvarritet prej muajsh. Zgjedhjet e 7 qershorit janë fundi i një zinxhiri të gjatë dështimesh institucionale dhe politike: nga moszgjedhja e presidentit brenda afatit kushtetues dhe

dekreti për shpërndarjen e Kuvendit, te vendimet e Gjykatës Kushtetuese, takimet pa rezultat mes udhëheqësve politikë, emrat e propozuar pa konsensus, bojkotimi i seancave dhe përplasjet e vazhdueshme pushtet-opozitë. Për partinë deri tash në qeverisje, Lëvizjen Vetëvendosje, e cila në zgjedhjet e 28 dhjetorit ka fituar mbi 51 për qind të votave, përgjegjësia për këtë bllokadë bie mbi opozitën, apo, siç e përshkruan udhëheqësi i saj, Albin Kurti, "bllokun opozitar", i cili, sipas tij, ka vepruar në mënyrë të koordinuar kundër Vetëvendosjes. "Të detyrosh një milion qytetarë të

shkojnë sërish në kutitë e votimit, vetëm katër muaj pasi ata në mënyrë plebishitare e shprehën vullnetin e vet, që dikujt nuk i pëlqen... Këta duan ta përshtatin popullin sipas tekeve të tyre, por kjo është e pamundur", ka thënë Kurti para mbështetësve të tij. Nga këndvështrimi i opozitës së deritashme, Kurti, pavarësisht mandatit të fortë elektoral, ka shmangur kompromisin politik dhe ka zgjedhur përplasjen si mënyrë veprimi. Sipas Bedri Hamzës, kryetar i PDK-së, partisë më të madhe opozitare, ai e ka shtyrë vendin drejt zgjedhjeve të reja, me synimin për ta forcuar më tej pozicionin e Vetëvendosjes. "Ai po kërkon nënshtrim, jo bashkëpunim. Po kërkon përkrahjen tonë jo për shtetin, por për pushtetin e tij. Jo për stabilitetin e vendit, por për stabilitetin e tij politik", ka thënë Hamza përmes një video-mesazhi të publikuar në rrjetet e tij sociale. LDK-ja, si partia e tretë për nga fuqia, ka përcaktuar

tashmë dy kandidaturat kryesore për garën e ardhshme: kryetarin e saj, Lumir Abdixhiku, si kandidat për kryeministër, dhe ish-presidenten Vjosa Osmani si kandidate për presidente, ndonëse kjo e fundit nuk është obligim kushtetues, pasi presidenti zgjidhet në Kuvend. Por, në një proces zgjedhor që de facto është nxitur nga dështimi për zgjedhjen e presidentit, këto emërime kanë marrë peshë të shtuar politike. Osmani, e cila në vitin 2021 ka garuar në listë të përbashkët me Kurtin, sot është e pozicionuar hapur kundër tij, pas prishjes së bashkëpunimit dhe mungesës së mbështetjes për mandatin e dytë presidencial. "Ka një gjë që historia e këtij populli na e ka mësuar gjithmonë: rrugët e mbyllura nga frikacakët, gjithmonë hapen nga populli dhe është populli ai që e di të vërtetën", ka thënë Osmani në një paraqitje para mbështetësve të saj. Populli, në fakt, e percepton

të vërtetën në mënyrën e vet. Më 7 qershor, ai do t'u drejtohet kutive të votimit për herë të pestë brenda një viti e gjysmë, nëse përfshihen një palë zgjedhje të rregullta parlamentare, një palë të parakohshme dhe dy runde të zgjedhjeve lokale. Për disa votues në Prishtinë, të anketuar për programin Expose të Radios Evropa e Lirë, vota mbetet mjeti i vetëm i ndikimit politik, por me gjithnjë e më pak besim në një garë që, sipas tyre, nuk matet më me programe, por me emra dhe llogari personale. "Unë mendoj që jo veç për president, por as për kryeministër, partitë nuk do të duhej të nxirrnin emra. Ato do të duhej ta nxirrnin programin në plan të parë dhe ai që fiton, ta nominojë një kandidat që mund t'i realizojë ato objektiva", thotë Behxhet Halili. "Këtu te ne, lufta me emra... sikur kemi hyrë në njëfarë gare për të realizuar ambiciet e individëve", shton ai. "Nëse nuk dalim të votojmë, nuk mund as të kritikojmë, as të përkrahim... Vota është

## KURTI PREZANTON PROJEKTET PËR KATËR HEKURUDHA DHE PESË DIGA GJATË TAKIMIT ME ODËN TREGTARE KOSOVARO-TURKE

PRISHTINË, 25 MAJ - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, dhe zëvendësministri në detyrë i Ekonomisë, Getoar Mjeku, mori pjesë në mëngjesin e shtruar nga Oda Tregtare Kosovaro-Turke. Në fjalën hyrëse, kryeministri në detyrë Kurti falënderoi Turqinë për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Republikës së Kosovës,

ndërsa theksoi se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve janë të shkëlqyeshme.

Krahas bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar në rritje me Turqinë, kryeministri në detyrë Kurti foli me theks të veçantë për atë në zhvillimin e industrisë së mbrojtjes të Republikës së Kosovës, përkatësisht prodhimin e municionit.

Gjatë këtij mëngjesi pune, kryeministri në detyrë Kurti shpali planet për katër hekurudhat të reja si lidhje me

rajonin dhe Evropën, por edhe rrjet i brendshëm: Fillimin e ndërtimit të hekurudhës Gjakovë-Shkodër, në kuadër të asaj Prishtinë-Durrës; pastaj përfundimin e linjës hekurudhore 10, Han i Elezit - Fushë Kosovë - Mitrovicë - Leshak; projektimin e linjës Prizren - Ferizaj - Gjilan - Bujanoc; si dhe, përgatitjen e asaj Prishtinë - Aeroport. Po ashtu, ai foli edhe për ndërtimin e pesë digave të reja në: Firajë, Pollatë, Kuçicë, Dragaçinë dhe Desivojcë.



## HYN NË FUQI LIGJI I RI PËR SHETËSINË



PRISHTINË, 25 MAJ - Ligji i ri për Shtetësinë e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi nga dita e sotme.

Kështu ka bërë me dije ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, përmes një video-mesazhi drejtuar bashkatdhetarëve.

Sveçla ka njoftuar bashkatdhetarët se Ligji i ri për shtetësinë e Kosovës sjell procedurë më të shpejta, më të thjeshta dhe më moderne për aplikuesit. "Një nga lehtësimet kryesore është rifitimi i shtetësisë për ju bashkatdhetarët, që për arsye objektive janë detyruar të

liroheshin nga shtetësia e Republikës së Kosovës. Nga 9 dokumente që kërkoheshin më parë, tani mjafton kërkesa e plotësuar nga ju si dhe dëshmia se nuk jeni të dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë në shtetin ku jetoni", ka thënë ai.

Ai ka njoftuar se për shtetësinë mund të bëhet edhe online përmes platformës e-Kosova, ndërsa, siç ka thënë ai, afati i shqyrtimit të kërkesës nga 6 muaj është shkurtuar në 30 ditë. Ligji i ri për shtetësinë e Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në seancën e 23 prillit 2026.

obligim i çdo qytetari", sipas Elmaze Gashit. "Do të dal të votoj, e për ndryshime ka pak gjasa", thotë bashkëqytetari i saj, Agim Mjeku. "Unë do të votoj që të mos më humbë vota. Nuk besoj se do të zgjidhet ndonjë gjë, do të shkojmë sërish në zgjedhje. Ky është medimi im", shton ai.

E, ky është edhe mendimi i Abit Hoxhës, ligjërues dhe hulumtues në Universitetin Agder në Norvegji, i cili thotë se Kosova rrezikon një cikël të përsëritur krizash politike, për shkak të mungesës së kompromisit mes partive.

Ai thekson se sistemi është ndërtuar për bashkëqeverisje dhe marrëveshje politike, jo për dominim, ndaj i konsideron të nxituara edhe kandidaturat për president përpara zgjedhjeve. "Pozita e presidentit të Kosovës përmbushet përmes Kuvendit të Kosovës dhe kandidaturat për president 'nuk çojnë ujë në mulli' të kompromisit politik", thotë Hoxha për Exposedenë.

Në këtë kontekst, ai e sheh veprimin e LDK-së me Osmanin më shumë si lëvizje të drejtuar nga interesat e brendshme partiake, sesa si kandidaturre reale që prodhon kompromis. "Është një emërtim kryekëput për konsum politik, nuk është

praktik, sepse presidenti duhet të zgjidhet si pjesë e kompromisit politik dhe duhet të negociohet. Nuk mund të kesh një kandidat për president që të negociohet kandidati për president", thotë Hoxha.

Në një situatë - në dukje të ngjashme - Osmani ka qenë edhe në vitin 2021, atëkohë ushtruese e detyrës së presidentes së Kosovës. Ajo i është bashkuar garës zgjedhore në një listë të përbashkët me Lëvizjen Vetëvendosje të Kurtit, duke synuar postin e presidentes, ndërsa Kurti atë të kryeministrit. "Sot dhe për katër vjetet në vijim, por edhe përtej këtyre katër vjetëve, ne jemi të vendosur për të luftuar në mënyrë të pakompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në vend, për të ndërtuar një shtet që prioritetizon arsimin dhe shëndetësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e secilit dhe secilës nga ju, duke siguruar një rimëkëmbje ekonomike të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe inovative", ka thënë Osmani më 14 janar 2021.

Synimet e tyre për postet kryesore u realizuan pas zgjedhjeve të 14 shkurtit atë vit, por partneriteti politik nisi të lëkundej edhe para se

të përmbylej një mandat.

Për Donika Eminin, nga Grupi Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë, modeli i vitit 2021 ka qenë i paprecedent dhe thelbësisht simbolik, pasi në një sistem parlamentar si Kosova, posti i presidentit nuk përcaktohet në kutitë e votimit, por përmes marrëveshjeve politike në Kuvend. Edhe kandidatura e tanishme e Osmanit, sipas saj, nuk e ndryshon këtë logjikë.

"Patëm apo nuk i patëm këta emra, konfigurimi, rezultati i zgjedhjeve do të përcaktojë se si këto forca politike do të navigojnë rreth njëra-tjetrës. Si një gjë simbolike mund të ketë efekt tek elektorati, por jo domosdoshmërisht është zgjedhje e krizës politike nëse e kemi një emër paraprakisht", vlerëson Eminin për Exposedenë.

Ajo shton se Osmani, për më tepër, nuk ka ofertë politike, por kryesisht kundërpërgjigje ndaj Vetëvendosjes, çka, siç thotë, mund të përfundojë duke e forcuar këtë të fundit.

Sipas saj, edhe PDK-ja, me refuzimin e bashkëpunimit me Nismën dhe mungesën e prurjeve të reja politike, mund të ndikojë në rritjen elektorale të Vetëvendosjes. "Nëse potencialisht ndodh që Lëvizja Vetëvendosje, edhe

me ndihmën e diasporës, rritet si parti politike, atëherë fuqia e saj negociuese do të jetë më e madhe dhe nuk do të ketë shumë hapësirë për manovara politike siç i kemi parë në dy vjetet e kaluar", thotë Eminin.

Ajo thekson se vetëm në një skenar të tillë do të mund të zgjidhej kriza aktuale, por paralajmëron se ai do të vinte me kosto për pluralizmin politik dhe vetë demokracinë, prandaj nuk do të ishte i shëndetshëm.

Sipas saj, dalja nga ngërçi kërkon vetëm vetëdijesim më të madh nga klasa politike se Kosova është një sistem multipartiak, i ndërtuar me Kushtetutë për të funksionuar mbi bazën e konsensusit.

Me Kurtin që këmbëngul në një president unifikues dhe jopartiak, Hoxha nuk e sheh as afër një disponim të tillë mes partive. Ai vlerëson se marrëveshja politike mund të vijë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. "E vetmja mënyrë për të ndërtuar një kompromis politik në Kosovë është një sfidë më e madhe... një problem në veri, një akt kundër shtetit të Kosovës, një sabotim, një kërcënim i madh. Diçka e tillë do të mund ta bashkonte faktorin politik, përndryshe nuk shoh dëshirë politike për

kompromis", thotë Hoxha. Aktualisht, ushtruese e detyrës së presidentes është kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu. Me Kushtetutë, ky mandat nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj, por nuk përcaktohet qartë se çfarë ndodh nëse brenda këtij afati nuk zgjidhet presidenti me kompetenca të plota.

E, një situatë e tillë, sipas një deklaratë të Kurtit më 24 prill, pak ditë para shpalljes së zgjedhjeve të 7 qershorit, nuk mund të përjashtohet plotësisht. "Nëse shkojmë në zgjedhje në qershor dhe Lëvizja Vetëvendosje me partnerët - GUXO, Alternativa e pakicat - nuk i mbërrin 80 deputetë, atëherë do të shkojmë sërish në zgjedhje në vjeshtë a dimër. Kujt i konvenon kjo?", ka pyetur Kurti.

Ndoshta askujt, ndoshta dikujt, por me siguri jo qëndrueshmërisë politike të Kosovës... ndonëse, sipas Abit Hoxhës, vendi është shndërruar në një sistem që "funksionon në krizë", por që në thelb përjeton stagnim. Sipas tij, mungesa e vendimmarrjes strategjike dhe e kompromisit ka krijuar një situatë ku "vendi ecën në vend", ndërsa humb mundësi zhvillimi dhe mbështetje ndërkombëtare.

## Rrustem Thaqi zgjidhet kryesues i ri i KGJK-së

PRISHTINË, 25 MAJ - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nën udhëheqjen e zëvendëskryesueses, Arjeta Sadiku, mbajti mbledhjen e 367-të me radhë. Gjatë këtij takimi anëtarët, si pikë të rendit të ditës kishin zgjedhjen

e kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kandidatët e nominuar për pozitën e kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Rrustem Thaqi dhe Besnik Bislimaj, nuk paraqitën programet e tyre para anëtarëve të KGJK-së, pasi

ato ishin prezantuar në mbledhjen e kaluar. Pas procesit të votimit me shumicë votash anëtarët e KGJK-së, zgjodhën Rrustem Thaqin në pozitën e kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Mandati i tij si

kryesues fillon nga data e zgjedhjes dhe është trevjeçar. Pas zgjedhjes, u bë edhe pranim-dorëzimi i detyrës ndërmjet ushtrueses së deritanishme të detyrës së kryesueses, Arjeta Sadiku dhe kryesuesit të ri, Rrustem Thaqi.



# SHBA: PRESIM QË PLANI I QEVERISË PËR XHANDARMËRINË TË JETË NË PËRPUTHJE ME ZOTIMET PËR RUAJTJEN E PAQES


PRISHTINË, 25 MAJ - Shtetet e Bashkuara presin që plani i Qeverisë në detyrë të Kosovës për themelimin e Xhandarmërisë të jetë "në përputhje me zotimet e saj për ruajtjen e paqes dhe sigurisë". Kështu tha për "Radion Evropa e Lirë" një zëdhënës i Ambasadës amerikane në Prishtinë, i cili shtoi se po "monitorojmë njoftimet e fundit sa i përket propozimit për krijimin e një force xhandarmërie në Kosovë". Më 19 maj, ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, njoftoi se janë ndërmarrë hapat e parë drejt themelimit të Xhandarmërisë së Kosovës. Ai tha se është nënshkruar dokumenti për krijimin e një grupi punues që do të bëjë analizimin dhe propozimin e modaliteteve për funksionimin e xhandarmërisë.

Sipas Sveçlës, kjo forcë do të ketë mision të qartë për ruajtjen e kufijve, integritetit dhe sovranitetit territorial, mbrojtjen nga terrorizmi, menaxhimin e trazirave dhe mbrojen e infrastrukturës kritike. Ndërkaq, nga NATO-ja, e cila që nga viti 1999 ka misionin e saj paqeruajtës në Kosovë, KFOR, i thanë Radios Evropa e Lirë se po vëzhgojnë nga afër deklaratimet e institucioneve në Kosovë për këtë çështje. "U përket atyre që të komentojnë në më shumë detaje" për këtë çështje, tha një zyrtar i NATO-s.

KFOR-i, i cili është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë - pas Policisë së Kosovës dhe misionit për Sundim të Ligjit të BE-së, EULEX - veç tjerash, është përgjegjës për sigurinë në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë.

Zyrtari i NATO-s tha se aleanca vazhdon të bashkëpunojë me të gjitha organizatat e sigurisë në Kosovë dhe të japë kontribut për siguri të qëndrueshme për të gjithë.

Zyrtari i aleancës ushtarake përfundimtare tha po ashtu se Ekipi Këshillues i NATO-s dhe Ndërlidhës (NALT) ka



mbështetur zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës "në përputhje me mandatin e tij origjinal për mbrojtje civile, përmes ndërtimit të kapaciteteve, edukimit dhe trajnimit". "Ne presim që organizatat e sigurisë në Kosovë të vazhdojnë këtë qasje bashkëpunuese, duke u koordinuar me KFOR-in për të kontribuar në sigurinë në Kosovë dhe stabilitetin rajonal, në të mirë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë", tha zyrtari i NATO-s në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë.

Ndërkaq, nga Ambasada gjermane në Prishtinë thanë për Radion Evropa e Lirë se do të përmbahen nga komentimi për këtë çështje.

Lajmi për ndërmarrjen e hapave të parë për krijimin e Xhandarmërisë është kritikuar nga autoritetet në Beograd, të cilat kanë thënë se "KFOR është forca e vetme legjitime e armatosur në Kosovë, përgjegjëse për kontrollimin dhe patrullimin përgjatë vijës administrative".

Ndonëse nuk dihen detaje se cili do të jetë misioni i saktë i Xhandarmërisë që Kosova mëton ta themelojë, drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Mentor Vrajolli, i tha më herët Radios Evropa e Lirë se një forcë e tillë sigurie do të mund të merrte kompetenca për ruajtjen e kufirit me Serbinë, që aktualisht është në mandatin e KFOR-it.

Sipas tij, Kosova duhet të përgatitet për çdo ndryshim të rolit të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, ndonëse tha se beson se ky mision do të qëndrojë për vite apo edhe një dekadë në vend.

Në këtë drejtim, ai kujtoi se shteti dhe KFOR-i kanë një marrëveshje që Forca e Sigurisë së Kosovës - që është në proces të transformimit në ushtri - të mos shkojë në veri pa pëlqimin e misionit paqeruajtës, duke thënë se Xhandarmëria do të mund të plotësonte këtë boshllëk. "Përderisa është një marrëveshje xhentlëmene mes KFOR-it dhe FSK-së që të mos jetë shumë prezente në pjesën veriore, Xhandarmëria do ta

krijonte një strukturë të re, e cila nuk është pjesë e kësaj marrëveshje xhentlëmene", tha Vrajolli.

Sipas tij, kjo do të mundësonte që rolet e kontrollit kufitar dhe veprimeve të tjera që i bëjnë KFOR-i të jenë të përbashkëta me njësi që mund të jenë në kuadër të Policisë, apo në kuadër të MPB-së, "e që do të fillonte sa më parë procesin e krijimit të kapaciteteve vendore dhe njohurisë se si të ballafaqohemi me kërcënime bashkërisht me KFOR-in në veri dhe pjesë të tjera të Kosovës".

Dërgimi i FSK-së - që është në proces të transformimit në ushtri - në veri të vendit është i mundur vetëm me pëlqimin paraprak të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, bazuar në zotimin e vitit 2013 nga Qeveria e Kosovës ndaj NATO-s.

Ky angazhim, i dhënë përmes një letre nga ish-kryeministri Hashim Thaçi drejtuar sekretarit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, mbetet në fuqi edhe sot, pavarësisht ndryshimeve në

mandatin e FSK-së.

Vrajolli vlerësoi se Kosova nuk ka nevojë që të ketë një xhandarmëri që do të merrej me incidente të brendshme, pasi vlerëson se Policia e Kosovës është e aftë të ballafaqohet me to. "Pikërisht fakti që vija kufitare mbrohet nga KFOR-i, KFOR ka përgjegjësi të zgjeruara në këtë fushë dhe nevojitet që ne të krijojmë institucionet tona që janë të gatshme ta zëvendësojnë KFOR-in kurdo që KFOR-i nuk është aty", u shpreh ai.

Xhandarmëria është një forcë e sigurisë që ka karakter ushtarak dhe kryen detyra policore. Në disa shtete mund të jetë pjesë e Ministrisë së Brendshme, në të tjera pjesë e forcave të armatosura.

Shumë shtete kanë xhandarmërinë e tyre, përfshirë edhe fqinji verior i Kosovës, Serbia, xhandarmëria e së cilës funksionon në kuadër të policisë.

Xhandarë kanë edhe shtete të tjera, përfshirë të NATO-s, sikurse është rasti i Francës. Në këtë shtet, Xhandarmëria është pjesë e forcave të armatosura.

## Prishtinasit kthejnë sytë nga transporti ekologjik

Prishtinë, 25 maj- Biçikleta, trotinetë e makina elektrike gjithnjë e më shumë po shihen në rrugët e kryeqytetit të

Kosovës, Prishtinë. Ky lloj transporti ndihmon në ruajtjen e mjedisit, teksa Komuna e Prishtinës dhe kompani private

ofrojnë për përdorim edhe biçikleta e trotinetë me çmime të ndryshme. Fotoreporterit i "Radios Evropa e Lirë", Bujar

Tërstena ka shkrepur disa fotografi në rrugët e kryeqytetit kosovar që shfaqin përdorimin e këtij transporti alternativ.



## NGA AAK NË "ALEANCA", ARDIAN GJINI ZGJEDHET KRYETAR I RI



PRISHTINË, 25 MAJ - Gjatë punimeve të Kuvendit të X-të Zgjedhor të Aleancës, pas përmbylljes së pjesës solemne, delegatët votuan për zgjedhjen e kryetarit të ri të partisë, Ardian Gjini, ku nga 461 delegatë, 453 votuan për, 2 kundër, 1 abstenoj dhe 5 vota ishin të pavlefshme. Në vijim, delegatët e Kuvendit aprovuan ndryshimet statutare, përfshirë ndryshimin e emrit të partisë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në

"Aleanca", zgjedhjen e Kryetarit të Nderit, Ramush Haradinaj, si dhe Këshillin e Nderit. Po ashtu, u zgjodh edhe Këshilli i Përgjithshëm, me përbërje prej 106 anëtarësh. Përbërjes së Këshillit të Përgjithshëm do t'i shtohet edhe Kryesia e re pas konstituimit, si dhe 3 përfaqësues nga diaspora që kanë marrë më së shumti vota në Kuvend. Aleanca e ka përmbyllur me sukses procesin e brendshëm zgjedhor, i nisur më 12

shkurt. Sipas njoftimit të kësaj partie, ky proces dëshmoi organizimin, unitetin dhe përkushtimin e strukturave tona në çdo nivel. "Falënderojmë të gjitha strukturat, delegatët dhe anëtarët që dhanë kontributin e tyre gjatë këtij procesi. Sukses kryetarit të ri, Ardian Gjini, dhe të gjithë të zgjedhurve në përgjegjësitë e reja, në shërbim të forcimit të Aleancës dhe angazhimit për Kosovën", është bërë me dije në njoftimin për media.

## MIRATOHET RAPORTI PËR MENAXHIMIN E LËNDËVE NË SMIL

PRISHTINË, 22 MAJ - Grupi Punues për Monitorimin e Rregullores Nr. 03/2021 për Menaxhimin e Lëndëve përmes Sistemit Elektronik SMIL, i kryesuar nga Visar Krasniqi, ka zhvilluar një takim pune në kuadër të hartimit të draft-rregullores së re. Në përbërje të Grupit Punues ishin Armend Hamiti, Arben Ismajli, Ermal Demhasaj, Nexhat Haziri, Besim Kusari, Ilir Hetemi dhe Aferdita Salihu. Grupi Punues fillimisht shqyrtoi raportin e monitorimit të hartuar pas realizimit të vizitave nëpër prokuroritë përkatëse. Andaj, pas pranimit të përgjigjeve nga këto, ka hartuar raportin e monitorimit me rekomandime konform afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit Prokurorial i Kosovës. Gjithashtu, Grupi Punues vazhdoi punën në hartimin e draftit të ri të Rregullores për

Menaxhimin e Lëndëve përmes Sistemit Elektronik SMIL, me fokus në avancimin e funksionaliteteve dhe rregullimin më të detajuar të çështjeve që ndërlidhen me qasjen në sistem, datën e pranimit të lëndëve, llojet e regjistrave, shpërndarjen e lëndëve, përpunimin e të dhënave gjatë shkëmbimit elektronik, trajtimin e rasteve konfidenciale, arkivimin e dokumenteve, përgjegjësinë disiplinore në rast të mos përdorimit të sistemit, si dhe gjenerimin dhe administrimin e raporteve statistikore. Po ashtu, gjatë procesit të draftimit janë adresuar sfidat e evidentuara gjatë monitorimit të zbatimit të sistemit, nevoja për harmonizimin e praktikave të menaxhimit të lëndëve në sistemin prokurorial, evidentimi i mangësive aktuale, përfshirja e proceseve shtesë në



SMIL, si dhe rritja e transparencës, efikasitetit dhe gjurmueshmërisë së proceseve të punës.

Në kuadër të këtij takimi, anëtarët e Grupit Punues diskutuan edhe për organizimin e mëtejshëm të punës, me ç'rast u

bë ndarja e detyrave dhe përgjegjësiave për hartimin e draft-rregullores dhe finalizimin e dispozitave të saj.

## EULEX-I DHE SHËRBIMI KORREKTUES PËRFUNDUAN TRAJNIMIN 15-DITORË PËR DREJTORËT E BURGJEVE DHE UDHËHEQËSIT E NJËSIVE



PRISHTINË, 25 MAJ - EULEX-i dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) përmbyllën me sukses trajnimin 15-ditorë me temë menaxhimin, i dedikuar për drejtorët e burgjeve dhe udhëheqësit e njësive nga mbarë Kosova. I mbajtur nga Njësia Korrektuese e EULEX-it, programi u fokusua në forcimin e shkathtësisë të udhëheqjes dhe menaxhimit, njëkohësisht duke rirforcuar profesionalizimin, llogaridhënien dhe respektimin

e të drejtave të njeriut në tërë sistemin korrektues. Tipar kryesor ishte qëndrueshmëria. Përmes qasjes 'trajnimi i trajnerëve', pjesëtarët e SHKK po ashtu u përgatitën edhe për t'u bërë trajnerë të ardhshëm, duke ndihmuar kështu për ndërtimin e kapaciteteve të brendshme afatgjate brenda shërbimit. Përgjatë tri blloqeve të trajnimeve të mbajtura mes marsit dhe majit 2026, në trajnim morën pjesë 22

pjesëmarrës nga komunitete të ndryshme të angazhuar në temat e udhëheqjes, menaxhimit etik dhe aplikimit të standardeve të pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut, përfshirë Rregullat Nelson Mandela, të Bangkokut dhe të Pekinit. Programi u përmbyll me ceremoni të ndarjes së certifikatave, si hap tjetër në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të sistemit korrektues të Kosovës.

## Mbahet punëtorja treditore për hartimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2027 - 2031

PRISHTINË, 25 MAJ - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka nisur procesin e hartimit të Strategjisë së re për Vetëqeverisje Lokale 2027 - 2031, përmes një punëtorie treditore të organizuar me mbështetjen e DEMOS. Në këtë punëtori morën pjesë Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së, Jeton Qela, përfaqësues të ministrive të linjës, institucioneve tjera relevante, organizatave të

ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe drejtorë të departamenteve të ministrisë. Gjatë punimeve u diskutuan rezultatet e vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 - 2026, përmes të cilave u definuan objektivat strategjike, nënobjektivat dhe aktivitetet kryesore që do të përfshihen në Strategjinë e re për Vetëqeverisje Lokale 2027 -

2031. Strategjia e ardhshme do të fokusohet në avancimin e vazhdueshëm të kornizës ligjore për vetëqeverisjen lokale, forcimin e zhvillimit ekonomik lokal, promovimin e qeverisjes së mirë dhe proceset e digitalizimit, inovacionit dhe modernizimit të administratës komunale. Hartimi i Strategjisë 2027 - 2031 synon krijimin e një qasjeje më



gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe zhvillimore të pushtetit lokal, duke

adresuar sfidat dhe prioritetet e komunave për vitet e ardhshme.

## Numri më i madh i përfituesve në muajin prill ishte nga skema e shtesave për fëmijë

PRISHTINË, 25 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e mirëqenies sociale për muajin prill 2026. Sipas të dhënave të muajit

prill 2026, struktura e përfituesve nga skemat e mirëqenies sociale, kryesisht ka në fokus mbështetjen e të moshuarve, kategoritë e dala nga lufta dhe familjet

në nevojë. Ndërkohë, skemat e tjera përfshijnë pensionet familjare, pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike, pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës,

pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pensionet e Trepçës, programi për mbështetje financiare për shtesat për fëmijë, si dhe skema të tjera specifike sociale.



## AKB-ja: 780 EURO PËR PUNËTORËT E SEKTORIT PUBLIK, 100 EURO PËR SEKTORIN PRIVAT - A ËSHTË KJO DREJTËSI EKONOMIKE?

PRISHTINË, 25 MAJ - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka shprehur shqetësimin lidhur me qasjen e pabarabartë ndaj punëtorëve në Kosovë, ku po krijohet një dallim i dukshëm mes sektorit publik dhe sektorit privat.

Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës nuk mund të ndërtojë politika sociale dhe ekonomike të qëndrueshme duke favorizuar vetëm një pjesë të punëtorëve, ndërsa lë anash sektorin që mban barrën kryesore të zhvillimit ekonomik dhe mbushjes së buxhetit të shtetit. "Sipas të dhënave të disponueshme, Kosova ka rreth

320 - 330 mijë punëtorë në sektorin privat, ndërsa sektori publik ka rreth 90 mijë të punësuar. Sektorin privat mbetet punëdhënësi më i madh dhe kontribuuesi kryesor në krijimin e të hyrave buxhetore përmes tatimeve, TVSH-së, kontributeve pensionale, prodhimit, tregtisë dhe shërbimeve. Nëse llogaritet një pagë e 13-të ose shpërblym me mesatare rreth 780 euro për rreth 90 mijë punonjës të sektorit publik, kostoja për buxhetin vlerësohet të jetë rreth 70 milionë euro. Ndërkohë, një mbështetje prej vetëm 100 euro për rreth 330 mijë punëtorë të sektorit privat do të kushtonte



rreth 33 milionë euro, ose afërsisht gjysmën e kostos së një mase të tillë për sektorin publik. AKB-ja ngre pyetjen publike si mund të shpërblehet vetëm një kategori e punëtorëve nga buxheti i shtetit, kur buxheti mbushet kryesisht nga puna, prodhimi dhe aktiviteti ekonomik i sektorit privat?", thuhet në

reagimin e tij.

Sipas AKB-së, punëtori i sektorit privat nuk është qytetar i rendit të dytë. "Ai është po aq taksapagues, votues dhe konsumator, sa edhe punëtori i sektorit publik. Ai paguan TVSH në çdo produkt që blen, kontribuon në fondet pensionale, mban familjen, krijon qarkullim ekonomik dhe merr pjesë në zhvillimin e vendit. Prandaj, krijimi i standardeve të ndryshme për qytetarët dhe punëtorët e Kosovës rrezikon të krijojë pabarazi ekonomike dhe sociale. AKB-ja nuk është kundër mbështetjes së sektorit publik, por është kundër

qasjeve që krijojnë privilegje për njërin sektor dhe lënë jashtë tjetrin. AKB-ja kërkon trajtim më të balancuar ndërmjet sektorit publik dhe privat, mbështetje të drejtpërdrejtë për punëtorët e sektorit privat, politika që forcojnë prodhimin, investimet dhe vendet e punës si dhe dialog institucional me komunitetin e biznesit para çdo vendimi me ndikim të madh ekonomik. Nuk mund të ketë shtet të fortë me sektor privat të dobësuar. Sektorin privat nuk është vetëm burim i taksave - ai është motori i ekonomisë së Kosovës", ka thënë kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini.

## GUVERNATORI ISMAILI PJESË E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE PËR AVANCIMIN E PROFESIONIT TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 MAJ - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Ahmet Ismaili, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, me temë "25 vjet në avancimin e profesionit: nga themelet drejt transformimit".

Në fjalën e tij hyrëse, guvernatori Ismaili theksoi rëndësinë e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në forcimin e transparencës, llogaridhënies financiare, qeverisjes korporative dhe besimit ndaj sistemit financiar. Ai vlerësoi kontributin e organizatave profesionale të fushës në ndërtimin e kapaciteteve profesionale dhe

në ngritjen e standardeve të raportimit financiar në Kosovë. Guvernatori Ismaili theksoi se për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, raportimi financiar cilësor, auditimi i pavarur dhe qeverisja e mirë korporative janë elemente të rëndësishme për stabilitetin financiar, integritetin e tregut dhe besimin në sektorin financiar. "Një sistem financiar i qëndrueshëm nuk mbështetet vetëm në kapital të mjaftueshëm dhe likuiditet të mirë, por edhe në informacion të besueshëm, pasqyra financiare të sakta dhe auditim profesional. Në këtë kuadër, auditimi i jashtëm dhe raportimi cilësor mbeten instrumente të rëndësishme për forcimin e disiplinës së tregut dhe të mbikëqyrjes financiare", theksoi guvernatori Ismaili. Gjatë fjalës së tij, Guvernatori nënvizoi se BQK-ja ka avancuar



në vazhdimësi kornizën rregullative, mbikëqyrëse, dhe të raportimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira evropiane, duke rritur fokusin në mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, qeverisjen, menaxhimin e rrezikut, dhe zgjerimin e kërkesave të raportimit krahas cilësisë së raportimit financiar. Ai shtoi se sektori financiar në Kosovë mbetet i qëndrueshëm, mirë i kapitalizuar dhe me tregues të shëndoshë, ndërsa ruajtja e kësaj qëndrueshmërie kërkon transparencë të lartë, raportim të besueshëm, auditim profesional dhe bashkëpunim

të vazhdueshëm ndërinsti-tucional.

Në këtë drejtim, guvernatori Ismaili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Financave, Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, Administratës Tatimore, organizatave profesionale, komunitetit akademik dhe sektorit privat, me qëllim adresimin e sfidave të përbashkëta dhe avancimin e mëtejshëm të standardeve profesionale. Ai rikonfirmoi zotimin e BQK-së për të fuqizuar bashkëpunimin ndërinsti-tucional dhe profesional, në përputhje me Planin Strategjik të BQK-së, i cili e vendos bashkëpunimin dhe koordinimin institucional si një nga prioritetet e rëndësishme për avancimin e objektivave të saj.

Në pjesën përfundimtare,

guvernatori Ismaili u ndal edhe te transformimet që po ndikojnë në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, përfshirë zhvillimet teknologjike, financat digjitale, përdorimin e inteligjencës artificiale, raportimin e qëndrueshmërisë dhe faktorët ESG.

Ai theksoi se këto zhvillime krijojnë mundësi të reja, por njëkohësisht kërkojnë kompetenca të përditësuara, etikë të fortë profesionale dhe ruajtje të parimeve themelore të integritetit, pavarësisë, kompetencës dhe përgjegjësisë publike. BQK-ja mbetet e përkushtuar të vazhdojë avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, në funksion të stabilitetit financiar, integritetit të sektorit financiar, transparencës dhe përafrimit me standardet evropiane.

## Prokuroria e Pejës ngriti 139 aktakuza ndaj 142 personave për ndërtime pa leje

Prishtinë, 25 maj - Prokuroria Themelore në Pejë, ka bërë me dije se për 16 muaj ka ngritur 139 aktakuza ndaj 142 personave për veprën penale "Ndërtimi pa leje".

Kurse, sipas njoftimit zyrtar, për periudhën kohore janar-prill 2026, pas veprimeve hetimore nga ky institucion, janë ngritur 27 aktakuza ndaj 29 personave për veprën penale të lartcekur.

"Prokuroria Themelore në Pejë mbetet e përkushtuar në luftimin e të gjitha veprave penale, me theks të veçantë ndaj ndërtimeve pa leje, duke ndërmarrë veprime konkrete

hetimore dhe ligjore ndaj çdo personi që vepron në kundërshtim me ligjin, me qëllim të mbrojtjes së rendit juridik dhe interesit publik", thuhet në njoftim.



# ENIGMAT E RENNES LE CHÂTEAU: NGA GRAALI TE MISTERET E EGJIPTIT

Rennes le Chateau është një fshat i vogël në Pirenejtë francezë. Në qendër të tij, një kishëz fshati e cila pak më shumë se një shekull më parë po shembej përtokë. Prifti që vendosi ta restaurojë quhej François-Bérenger Saunière: ai vendim, i cili ndryshoi jetën e shumë njerëzve duke filluar me të tijën, i dha jetë një prej mistereve më kompleksë e më të papenetrueshëm të historisë së të gjithë kohërave. Afro 200 banorët që jetojnë aty bashkëjetojnë me një seri pyetjesh... e para prej të cilave nuk mund të mos jetë kjo: A është vërtetë e mundur që në një vend të vogël të përqëndrohen, shekull pas shekulli, kaq shumë enigma?

Çfarë e lidh këtë fshat të vogël francez me pasionin e Jezusit? Përse ky vend ishte kaq shumë i rëndësishëm për romakët dhe visigotët, për templarët dhe katarët, për Nicolas Poussin, një piktor i madh i viteve gjashtëqind dhe për vëllanë e Perandorit të Austrisë? Përse artistë dhe njerëz të pushtetshëm gjatë shekullit të fundit kanë dashur të vizitojnë Rennes le Chateau?

Përse në kishën e restauruar nga Saunière ka hieroglife që të çojnë në misteret e Egjiptit, dhe pse inicialet e emrave të shenjtëve që janë pikturuar në statuja, formojnë emrin GRAAL? Përse zonja e shërbimit dhe trashëgimtarja e Berengere, Marie Denardaud thoshte se “njerëzit që jetojnë këtu ecin mbi flori dhe nuk e dinë”? Përse në derën e hyrjes në Kishën kushtuar Mari Magdalenës, një fakt që siç do ta shohim nuk është i rastësishëm, François-Bérenger Saunière kërkoi që të shkruhet në latinisht: “Ky është një vend i tmerrshëm”?

## Prifti i varfër mbërrin në Rennes le Chateau dhe gjen një ... thesar

Kur, në vitin 1885 Saunière mbërrin në Rennes le Chateau, ai gjen një mal me probleme përpara tij. Prifti i varfër duhet që të vuajë nga kufizime të mëdha ekonomike si dhe të përballet me problemin që paraqet një kishë në qendër të fshatit, e cila po shembej copë pas cope. Pavarësisht gjithë këtyre i hyn punës dhe, pak nga pak, arrin të vërë në vijë punët. Fillimisht me shumë mundim dhe më pas, krejt papritur, situata ndryshon. Dhe ndryshon në një datë të saktë. Pas pothuajse shtatë vitesh kufizime dhe shtrëngime, Saunière shkruan në ditarin e tij: “Sot kam gjetur një thesar!” Është ndoshta kjo dita kur Saunière, duke spostuar altarin e Kishës – që në atë kohë ishte i

ngjitur pas murit për arsye se prifti që mbante meshën ndryshe nga sot, u kthente shpinën besimtarëve – gjeti katë pergamenë antikë në brendësi të një shtylle mbajtëse. Dy prej këtyre pergamenëve e kishin origjinën që në Mesjetë, ndërsa dy të tjerë ishin shkruar nga një paraardhës i Saunière, abati Antoine Bigou, i cili kishte drejtuar para tij kishën e Rennes.

Saunière ia çon menjëherë këta dokumenta peshkopit të tij në fshatin pranë, Carcassonne dhe ky i fundit e autorizon që të shkojë në Paris. Çfarë të bënte në Paris? Nuk është shumë e qartë: ndoshta për të konsultuar pergamenët me ndonjë ekspert, por edhe për të bërë ndonjë verifikim personal. Në fakt, është e sigurtë se përveç se ka frekuentuar disa qarqe fetarë në Paris, Berengere jepet edhe pas jetës së bukur dhe kalon shumë kohë në Louvre, dhe saktësisht në sallat ku qëndrojnë të ruajtura veprat e një piktori të madh manierist të gjashtëqindës: Nicolas Poussin.

Mes pikturave të Poussinit, njëra në mënyrë të veçantë i interesonte Saunière: “Pastorët e Arkadias”, e realizuar në vitin 1640, ku paraqitet një sarkofag antik me mbishkrimin “Et in Arcadia Ego”. Shumëkush këmbëngul se sarkofagu dhe panorama që e rrethon kujton një skenar me të vërtetë ekzistent në rrethinat e Rennes le Chateau, edhe pse nuk rezultojnë që Poussin (një piktor shumë i njohur dhe shumë i studiuar) nuk ka qenë kurrë në ato anë.

Dhe Berengere do të kërkojë një kopje të kësaj pikturë, bashkë me disa kopje të pikturave të tjera. Çuditërisht, mes veprave që filluan t'i interesojnë ishte edhe portreti i një pape shumë të veçantë: Celestino V, një Papë që nuk shkoi asnjëherë në Romë dhe i cili jetoj dhe vdiq në l'Aquila. Celestino, mes shumë gjërave të tjera, ishte paraardhësi i Bonifacit VIII, i cili pati shumë rol në shpërndarjen e përgjakshme të urdhërit të Templarëve, në fillimin e Treqindës. Një rrethanë kjo që shndërrohet në unike për arsye se historia e templarëve dhe ajo e Renne kanë lidhje me njëra tjetrën...

## Çfarë kishte mësuar Saunière? Çfarë lloj thesari kishte gjetur?

Duke u kthyer në Rennes le Chateau, brenda pak vitesh, thajse si për mrekulli, Saunière do të arrijë të ristrukturojë kishën me një shpenzim të madh mjetesh ekonomike dhe ai vetë duke kaluar në një stil jetese të kushtueshëm, pa



dhënë asnjëherë shpjegime për këtë ndryshim të papritur. Disa kanë përllogaritur se brenda pak vitesh, Saunière shpenzoi afro 15 milionë euro. Jo vetëm kaq, pas atij zbulimi, abati nisi të kryejë ekskursione të gjatë, pas të cilëve rikthehej me qerre të mbushura me gurë, të cilët mbyllej dhe i studionte në sakristi.

Çfarë kishte mësuar Saunière? Çfarë lloj thesari kishte gjetur? Hipoteza e parë: ka nga ata që mendojnë për gjetjen e një thesari në kuptimin klasik: flori, gurë të çmuar, para... dhe në këtë rast do të bëhej fjalë për vlera të krijuara në epoka shumë të largëta. Përse thesari i Rennes le Chateau është i ndryshëm nga gjithë të tjerët? Pak sepse është më antik, dhe pak sepse bëhet fjalë për një thesar të përbërë nga shumë thesarë, të cilët të formuar përgjatë historisë, për një arsye apo për një tjetër, kanë përfunduar gjithmonë nga këto anë. Ajo që tashmë i përket këtij fshati të vogël është një sagë e jashtëzakonshme, që nis nga thesari antik i Tempullit të Solomonit në Jeruzalem, kalon nëpër romakët dhe visigotët e lashtë, kalon nëpër katarët, heretikët e zhdukur jo shumë larg prej këtu, në Montsegur në vitin 1244 dhe mbërrin tek Kalorësit Templarë.

Në një rast shumë të çuditshëm të historisë, kur visigotët plaçkitën Romën, morën edhe thesarin e tempullit të Jeruzalemit që Titi kish marrë me vete, kur kishte pushtuar qytetin në viti 66. Migrimi i tyre nuk u ndal në Itali por vazhdoi deri në Pirenejtë, ku u krijua për pak kohë një mbretëri visigote. Por coincidenat nuk mbarojnë këtu: në fakt, gjithmonë në këtë zonë i pati rrënjët herezia e katarëve, mbrojtës të mundshëm të pasurive shumë të mëdha që u zhdukën me eliminimin e rezistencës së fundit të katarëve, shumë pranë në Mont Segur. Edhe shumë

fortesa të templarëve u ngritën në këtë zonë, sipas disave, a thua duhej të mbronin një thesar shumë të madh që vazhdonte të pasurohej me të ardhur të tjerë.

Dhe, gjithmonë nëse duam të vlerësojmë coincidenat, nuk mund të shpëtojë fakti që, nëse e gjithë kjo është e vërtetë, atëherë thesari mitik i Tempullit të Jeruzalemit u zbulua disa shekuj më vonë se ishte ruajtur nga një urdhër kaloresiak, i cili e kish marrë emrin pikërisht nga fakti që qendrën e tij të parë e kish patur, menjëherë pas kryqëzatës së parë, në njërin krah të atij, që dikur kishte qenë tempulli i madh i Solomonit.

## Një hipotezë e dytë


Hipoteza e dytë: Thesari i Saunière nuk ishte një thesar i vërtetë, por një seri dokumentash në gjendje që të konfirmonin një legjendë antike, që i përkiste pikërisht këtij vendi. Sipas kësaj legjende, Jezusi nuk vdiq në kryq por, i shpëtuar nga të tijtë, arriti të largohet nga Palestina dhe të mbërrijë në jug të Francës. Bashkë me të, në grupin e vogël të hebrenjve kristianë që kishin marrë arratinë, sipas legjendës, thuhet të ketë qenë edhe Mari Magdalena, prostituta që, sipas Biblës, Jezusi e kishte konvertuar. Një tjetër version i legjendës thotë që në këto anë erdhi vetëm Mari Magdalena me disa hebrenj të tjerë.

Sido që të jetë, në tokën ku thuhet se shekuj më parë ishin strehuar disa pasardhës të Jezusit, Thesari i Tempullit të Jeruzalemit gjeti vendndodhjen e tij të re. Nga ai komunitet i vogël hebrenjsh të arratisur nga Palestina do të ishte zhvilluar më pas linja e pasardhësve që do t'i jepte jetë dinastisë së parë të mbretërve francezë, merovinjëve. Pra, pasuria e Berengere mund të ketë ardhur nga shitja e dokumentave që kanë lidhje me këtë histori, apo

nga ndonjë njohuri arkaike e fetare. Hipoteza e tretë: Kjo është më prozaikja dhe ka lidhje me faktin që François Berengere Saunière ka qenë i dhënë pas një trafiku donacionesh, dhe të thuash të drejtën, nuk kuptohet se si mund të shpjgohet lëvizja e madhe e personazheve dhe parasë, që rrethuan priftin gjatë gjysmës së dytë të jetës së tij.

Një gjë është e sigurtë: brenda pak viteve, nga një prift anonim fshati, Saunière u shndërrua në një njeri të pasur dhe të rëndësishëm. I pasur sepse shpenzonte pa hesap, duke ndërtuar një shtëpi luksoze, kopshtin, Belvederen si dhe kullën e Magdalës për bibliotekën. Bleu troje dhe dha para për bamirësi. Por ndërtoi edhe një rrugë për të mbërritur në Rennes Le Chateau. Një vepër kjo që mund ta lidhim qoftë me faktin që me siguri Saunière donte të ndante me bashkëfshatarët e tij një pjesë të pasurisë, qoftë sepse donte t'ua lehtësonte udhëtimin njerëzve të rëndësishëm që vinin ta takonin. Mes tyre Emma Calve, këngëtarja lirike më e njohur e kohës, një lloj Maria Callas, por edhe Sekretari i shtetit për Kulturën si dhe fisnikë dhe bankierë të shumtë. Por ai që shkakton më shumë habi është duka Xhovani i Habsburgeve, vëllai i Perandorit të Austrisë, Franc Jozefit, i cili i dërgoi shumën të mëdha parash Saunierit.

Saunière nuk jetoj megjithatë kurrë në shtëpinë luksoze dhe në shtratin e atjeshem u shtri vetëm kur ishte i vdekur: kjo shtëpi i shërbente për të pritur, në një tokë jo shumë mikpritëse, vizitorët e rëndësishëm, si përshebull vëllanë e perandorit të Austrisë. Dhe fluksi i njerëzve të famshëm që kanë vizituar Renne Le Chateau, një fshat ku nuk ka asgjë që të mos lidhet me jetën e çuditshme të Berengere Saunière, është i



## Kreshnik Uka, "Ylli i Javës" në Superligën e Kosovës në futboll

PRISHTINË, 25 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ia ka ndarë çmimin tradicional "Ylli i Javës", futbollistit të KF Drenicës, Kreshnik Uka, pas paraqitjes së tij të jashtëzakonshme në fitoren

ndaj Ferizajt me rezultat 3:2, ku ka realizuar dy gola dhe ka kontribuar me një asistim. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Pasi ka marrë këtë çmim, Uka është shprehur i lumtur për

suksesin e arritur dhe rëndësinë e kësaj fitoreje për skuadrën. "Ndeshjen e fundit e kemi ndaj Prishtinës si mysafir dhe e dimë që do të jetë shumë e vështirë, por ne do të shkojmë për tri pikë për t'iu

shmangur barazhit. Faleminderit Federatës për çmimin 'Ylli i Javës', si dhe të gjithë bashkëlojtarëve, stafit të trajnerëve dhe tifozëve për përkrahjen e tyre", ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.



## VUSHTRRIA KAMPIONE E LIGËS SË PARË, RIKTHEHET NË SUPERLIGË BASHKË ME FERONIKELIN '74

PRISHTINË, 25 MAJ - Ka përfunduar edicioni garues në Raiffeisen Ligën e Parë, me një xhiro të fundit tejet interesante dhe vendimtare për kreun e tabelës dhe garën për barazh. Vushtrria është shpallur kampione e Ligës së Parë dhe ka siguruar rikthimin direkt në Albi Mall Superligë, pas fitores së madhe në Gjakovë ndaj Vëllaznimit, me rezultat 3:1. Skuadra e drejtuar nga Armend Dallku e mbylli kampionatin në vendin e parë me 75 pikë. Ndeshja në Gjakovë ka nisur me mirë për vendasit, të cilët kanë kaluar në epërsi në minutën e 13-

të me golin e Dardan Jasharit. Megjithatë, Vushtrria ka reaguuar në pjesën e dytë. Fillimisht rezultati është barazuar në minutën e 51-të, pas një aksioni ku topi ka përfunduar në rrjetë pas devijimit të Urim Statovcit dhe ndërhyrjes së pasuksesshme të mbrojtjes vendase. Në minutën e 77-të, Urim Statovci, ka shënuar nga pika e bardhë për 2:1, ndërsa vetëm katër minuta më vonë, Erjon Krasniqi ka realizuar golin e tretë dhe vulosi fitoren e madhe të Vushtrrisë. Me këtë fitore, Vushtrria është rikthyer në elitën e futbollit të



Kosovës pas gjashtë edicioneve në Ligën e Parë. Ky rikthim vjen pas një gare të fortë dhe dramatike deri në xhiron e fundit. Në Superligë është rikthyer edhe FC Feronikeli '74, që në xhiron e

fundit ka shënuar fitore ndaj Ramiz Sadikut në Prishtinë, me rezultat 2:0. Golat për skuadrën nga Drenasi janë realizuar nga Kreshnik Bahtiri në minutën e 20-të dhe Avni Selmani në minutën e 80-të. Feronikeli '74 e ka mbyllur kampionatin në vendin e dytë me 74 pikë dhe ka siguruar rikthimin në Superligë pas vetëm një edicioni të kaluar në kategorinë e dytë të futbollit kosovar. Ndërkohë, Liria ka siguruar pjesëmarrjen në barazhin e Ligës së Parë, pas fitores bindëse në udhëtim ndaj Dinamos së Ferizajt, me rezultat 5:1. Skuadra

prizrenase ka realizuar të pesë golat në pjesën e parë, përmes Dijar Nikqit, i cili ka shënuar dy herë, si dhe Muhamed Useinit, Albion Kurtajt e Vigan Ademit. Liria dhe Dinamo e kanë përfunduar kampionatin me nga 71 pikë, por skuadra prizrenase është renditur e treta falë bilancit më të mirë në ndeshjet e ndërsjella. Vëllaznimi, pas humbjes ndaj Vushtrrisë, përveç se ka mbetur pa rikthim në elitë, ka mbetur edhe jashtë garës për barazh, duke e përfunduar kampionatin me 70 pikë.

## SUNDERLANDI I XHAKËS RIKTHEHET NË EVROPË PAS MË SHUMË SE 50 VITESH

SUNDERLAND, 25 MAJ - Sunderlandi ka siguruar pjesëmarrjen në futbollin evropian për herë të parë që nga viti 1973, pas një fitoreje 2-1 në shtëpi ndaj Chelseat, duke i lënë "Blutë" jashtë garave evropiane. Falë këtij triumfi, skuadra e Granit Xhakës ka siguruar pjesëmarrjen në Ligën e Evropës për sezonin e ardhshëm, duke e mbyllur kampionatin në mënyrën më të mirë të mundshme. Skuadra vendase ka zhvilluar një paraqitje shumë të mirë para tifozëve të saj, duke treguar karakter dhe vendosmëri në



ndeshjen vendimtare për objektivat evropiane. Në anën tjetër, Chelsea ka zhgënjyer sërish në fundin e sezonit dhe ka mbetur jashtë zonës që

siguron garat evropiane. "Blutë e Londrës" e kanë mbyllur edicionin në pozitën e dhjetë, larg pritshmërive të tifozëve dhe drejtuesve të klubit. Pjesë e suksesit të Sunderlandit ishte edhe mesfushori shqiptar Granit Xhaka, i cili së bashku me skuadrën e tij do të garojë sezonin e ardhshëm në Ligën e Evropës, kompeticionin e dytë më të rëndësishëm për klube në Evropë. Kualifikimi në garat evropiane konsiderohet një sukses i madh për Sunderlandin, që ka zhvilluar një sezon mjaft pozitiv në elitën e futbollit anglez.

## FRANCO FODA FTON ANDI HOTIN PËR MIQËSORET E QERSHORIT

PRISHTINË, 25 MAJ - Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda ka ftuar qendërmbrojtësin Andi Hoti për dy miqësoret e muajit qershor. Foda pritet t'i pushojë disa nga lojtarët kryesorë për t'iu dhënë hapësirë lojtarëve të rinj dhe për të parë se cili do të përshtatet më mirë në stilin e tij të lojës. Një nga lojtarët që më parë nuk është ftuar është Hoti, i skuadrës së Bundesliga 2, Eintracht Braunschweig. Ka qenë vetë klubi gjerman që ka konfirmuar ftesën. "Derisa ekipi i parë i Eintrachtit është zyrtarisht në pushime, dy lojtarë ende kanë lojë për të



zhvilluar për kombëtaret. Qendërmbrojtësi Andi Hoti është ftuar te Kosova. Hoti po përgatitet për dy miqësoret me Kosovën", ka njoftuar klubi gjerman. Ndërkohë, rikujtojmë Kosova përballet me Çekinë në udhëtim më 31 maj, kurse më 4 qershor do të luajë ndaj Andorrës në "Fadil Vokrri".

## Për herë të parë në histori të klubit, Como e Mërgim Vojvodës kualifikohet në Ligën e Kampionëve

COMO, 25 MAJ - Como ku luan Mërgim Vojvoda ka shkruar histori në Serie A, duke siguruar një kualifikim të jashtëzakonshëm në Ligën e Kampionëve pas një fitoreje bindëse 4-1 ndaj Cremonese, në një natë vendimtare për garën evropiane në kampionatin italian. Ndeshja ka nisur me ritëm të kujdesshëm nga të dyja skuadrat, por Como ka arritur të marrë kontrollin gradualisht dhe të gjejë epërsinë në pjesën e parë. Goli i parë ka ardhur nga

Jesus Rodriguez, pas një devijimi që ka përfunduar në rrjetë nga Alberto Grassi, duke i dhënë avantazhin skuadrës vendase. Në pjesën e dytë, Como e ka rritur edhe më shumë ritmin dhe ka arritur ta dyfishojë rezultatin përmes Anastasios Douvikas, i cili ka shënuar pas një asistimi të bukur nga Rodriguez, duke e çuar në 14 numrin e golave të tij në këtë sezon. US Cremonese është rikthyer përkohësisht në lojë pas një

penalltie të shndërruar nga Federico Bonazzoli, pas një faulli të shkaktuar nga Jacobo Ramon ndaj Jamie Vardy. Megjithatë, ndeshja ka marrë kthesë të shpejtë kur Matteo Bianchetti ka shkaktuar një tjetër penallti, ndërsa Alberto Grassi është ndëshkuar me karton të kuq, duke e lënë Cremonesen me një lojtar më pak dhe në vështirësi të mëdha. Në fund, kapiteni Lucas Da Cunha ka vulosur fitoren me dy gola në minutat e fundit të ndeshjes, duke konfirmuar një

sezon historik për Comon. Ky sukses është bërë edhe më i madh pasi AC Milan ka pësuar humbje 2-1 ndaj Cagliari, rezultat që i ka lejuar Comos të përfundojë në pozitën e katërt të tabelës dhe të sigurojë një kualifikim të jashtëzakonshëm në Ligën e Kampionëve, vetëm dy vite pas ngjitjes në elitën e futbollit italian. Përpos Milanit edhe Juventuesi ka mbetur jashtë Ligës së Kampionëve. Dy gjigantët italianë sezonin e ardhshëm do të luajnë në Ligën e Evropës.





Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë

**NJOFTIM PËR KORRIGJIM TEKNIK TË BAZËS JURIDIKE NË KONKURS PUBLIK**

KRM "Uniteti" Sh.A – Mitrovicë, bazuar në nenin 21, nenin 25 paragrafi 25.2 pika h të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/2008, dt. 15.06.2008), respektivisht nenin 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 13/2012, dt. 30.05.2012), Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, njofton të gjithë kandidatët e interesuar dhe opinionin publik se në Konkursin Publik për pozitën "Auditor i Brendshëm", të publikuar më datë 05.06.2026, është evidentuar një gabim teknik në citimin e aktit nënligjor që rregullon procedurat e konkursit në sektorin publik.

Në tekstin e konkursit, referenca:

"Udhëzimi Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik",

zëvendësohet me:

"Udhëzimin Administrativ (MFPT) nr. 01/2024 për Procedurat e Konkursit në Sektorin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MFPT) nr. 03/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MFPT) nr. 01/2024 për Procedurat e Konkursit në Sektorin Publik".

Ky korrigjim paraqet harmonizim teknik dhe juridik të bazës ligjore në fuqi dhe nuk ndryshon përmbajtjen, kriteret, kushtet, procedurat, afatet apo vlefshmërinë juridike të konkursit të shpallur.

Në pajtim me nenin 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organi publik ka të drejtë që përmes një akti të ri administrativ të bëjë korrigjimin, plotësimin apo harmonizimin e aktit paraprak, pa cenuar efektet juridike të procedurës administrative në zhvillim, kur korrigjimi ka karakter teknik dhe nuk prek të drejtat apo interesat juridike të palëve.

Deri në momentin e evidentimit të gabimit teknik, nuk ka aplikuar asnjë kandidat për pozitën e shpallur, andaj ky korrigjim nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të asnjë pale.


Afati i Konkursit Publik mbetet i njëjtë dhe vazhdon të jetë në fuqi deri më datë 05.06.2026.

Të gjitha dispozitat tjera të Konkursit Publik mbeten në fuqi dhe zbatohen të pandryshuara.

Ky njoftim hyn në fuqi ditën e publikimit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIT**

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 22.04.2026 për vendin e punës:

**I. Pozita:** Zyrtar për regjistrim dhe ruajtje të materialit arkivor  
**Numri i pozitave:** Një (1)  
**Numri i referencës:** ZRMA/ZKA/07-04/26

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 831 të datës 25.05.2026.

Prishtinë, 25.05.2026 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore


**SAOPËSTENJE O PONIËSTENJU KONKURSA**

Nacionalna kancelarija revizije saopëstava da se poništava konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnoj veb stranici i na oglasnoj tabli Nacionalne kancelarije revizije dana 22.04.2026. godine za sledeće radno mesto:

**I. Pozicija:** Službenik za registraciju i čuvanje arhivske grade  
**Broj pozicija:** Jedna (1)  
**Broj reference:** ZRMA/ZKA/07-04/26

Konkurs se poništava na osnovu Odluke br. 831 od 25.05.2026. godine.

Prishtina, 25.05.2026.godine Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI"SH.A - Mitrovicë

**NJOFTIM PËR KORRIGJIM TEKNIK**

Me qëllim të korrigjimit të një gabimi teknik në tekstin e shpalljes së konkursit të publikuar më datë 21.05.2026 dhe duke u bazuar në nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bëhet korrigjimi si në vijim:

Te kriteri i shkollimit për pozitën Faturiste në vend të "Përgatitje Universitare" duhet të jetë "Shkolla e Mesme"

Të gjitha kushtet dhe dispozitat tjera të shpalljes mbesin në fuqi.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Liridon Isufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Hilmi Morina shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Jetulla Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Arjana Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.
- Sabit Ferati shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.
- Çlirim Gjuraraj nga Gërqina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.
- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U "Engjëll Gjoni", Novosellë, nga klasa 1-8.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Baçelor i Edukimit Fillor.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



